



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

MEMORANDUM SHPJEGUES

PËR

PROJEKT RREGULLOREN NR. X/2023 PËR MENAXHIMIN, RUAJTJEN DHE TJETËRSIMIN E PASURISË JO FINANCIARE NË KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS DHE GJYKATA

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Kjo rregullore ka për qëllim krijimin e rregullave dhe procedurave standarde për menaxhimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe gjykatë.

Synohet të sigurohet mbajtja e saktë e të dhënave nëpërmjet mirëmbajtjes sistematike të regjistrit të pasurive jo financiare, si pjesë e "SIMFK-ut" ose sistemeve të ngjashëm. Qëllimi është vlerësimi dhe raportimi i saktë i vlerës së tyre, si dhe proceset efikase dhe transparente të tjetërsimit të pasurive jo financiare.

Rregullorja përcakton përgjegjësitë e zyrtarëve për ruajtjen dhe menaxhimin e

	<p>pasurisë jo financiare, klasifikimin e pasurisë, si dhe themelimin dhe përgjegjësitë e komisioneve për pranimin, inventarizimin, vlerësimin dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare. Ajo gjithashtu përfshin masat ndëshkuese për dështimin sistematik të detyrave nga punonjësit e Këshillit Gjyqësor dhe gjykatave.</p> <p>Dispozitat e saj parashihen të zbatohen në të gjitha programet buxhetore të Këshillit, duke kërkuar dokumentimin, ruajtjen, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare për të mbrojtur atë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.</p>
2. Arsyetimi i aktit normative	<p>Arsyeja e hartimit të projekt Rregullores X/2023 për Menaxhimin, Ruajtjen dhe Tjetërsimin e Pasurisë jo Financiare në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykatë është për të krijuar rregulla standarde për menaxhimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare.</p> <p>Ky akt është i nevojshëm për disa arsye të rëndësishme.</p> <p>Së pari, synon krijimin e procedurave të sakta dhe sistematike për mbajtjen e të dhënave, duke lejuar vlerësimin dhe raportimin e vlerës së pasurisë jo financiare.</p> <p>Së dyti, përcakton përgjegjësitë dhe krijon komisione të specializuara për ruajtjen, menaxhimin, vlerësimin dhe tjetërsimin e</p>

	<p>pasurisë jo financiare, me qëllim të sigurisë dhe mbrojtjes së saj nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.</p> <p>Ky akt promovon menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe rregullat e qarta në Këshillin Gjyqësor dhe gjykata për të garantuar transparencën dhe përdorimin e saktë të pasurisë jo financiare.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të Draftit të Rregullores X/2023 për Menaxhimin, Ruajtjen, dhe Tjetërsimin e Pasurisë jo Financiare në Këshillin Gjyqësor të Kosove dhe Gjykata.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 1 korrik 2023.</p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft</p>

rregullore, përmes postës elektronike në këtë
e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net